

Koncepti i fesë dhe prijësisë tek Imam Huseini

S.H.M Xhafri

Revista al-Serat, vëll. XI, nr. 1

Vetëm herë pas here ndodh që të ngrihet mbi nivelin e zakonshëm ndonjë shpirt i rrallë, i cili, duke e patur parë Zotin ballë për ballë e pasqyron më qartë qëllimin hyjnor dhe i vë në zbatim më trimërisht udhëzimet hyjnore. Drita e një njeriu të tillë shkëlqen si fanar i fortë në një botë të errët e të çrregullt. Konceptet tona mbi vlerat njerëzore, dinjitetin njerëzor dhe lirinë njerëzore kuptohen më mirë sot, sepse midis të tjerëve ka ardhur në jetë një personalitet që është flakërim nga Zoti. Vuajtja e tij trupëzon krenarinë e njerëzimit dhe flijimi i tij pasqyron durimin e përjetshëm të madhështisë së njeriut. Një shpirt i patrembur, vullnet i pathyeshëm e pasion mbinjerëzor për të vërtetën dhe drejtësinë janë karakteristikat e tija kryesore. Dhe ai burrë është Husein ibn 'Aliu, nipi i Pejgamberit të Islamit. Për ne ai përfaqëson idealin më të pastër, më të lartësuar e më frymëzues që njuh njeriu. Ai është personi që i ka mësuar njeriut se vdekja nuk është më e keqe se një jetë e çnderuar. Ai i tregoi botës kuptimin e vërtetë të fesë dhe funksionin e prijësve të njerëzimit.

Feja si e tillë është po aq e vjetër sa edhe njeriu dhe përbën një pjesë të pashkëputshme të historisë së tij, ndaj dhe ka qenë përherë objekt mendimi, spekulimi, interpretimi si dhe kundërshtimi e kritikimi. Që nga forma e saj më e hershme e animizmit, adhurimit të natyrës dhe totemizmit deri tek ajo e monoteizmit të kulluar, feja në kuptimin më të gjerë simbolizon e artikulon vlerat dhe përkushtimet më themelore të shoqërisë. Për më tepër, te njeriu ekziston një shtysë themelore jo thjesht për të jetuar, por për të jetuar fisnikërisht. Kur pasioni ynë për jetë fisnike merr mbështetje kozmike, ne fitojmë hovin e veçantë të fesë. Nuk ka njeri që herët a vonë të mos e shtrojë pyetjen: Çfarë jam unë? Ç'prejardhje kam? Cili është fati im?

Feja mbështetet në zbulimin e vlerës dhe dinjitetit thelbësor të individit dhe marrëdhënien e tij me një botë më të lartë realiteti. Kur qenia njerëzore përndijon se i përket një rendi më të lartë të realitetit sesa natyra e thatë, ai nuk mund të kënaqet me suksesin e kësaj bote ose arritjet materialiste. Fakti se ai është i aftë për martirizim për hir të idealeve tregon që ai jeton *në* dhe *për* një botë realitetesh të përjetshme. Adhurimi është zgjatja e njeriut për të arritur hyjnoren. Feja është disiplina që prek ndërgjejen e njeriut dhe na ndihmon të luftojmë të keqen dhe ndytësinë, na shpëton nga lakmia, epshi e urrejtja, çliron fuqi morale dhe i jep kurajo njeriut në përpjekjen e shpëtimit të tij nga dëshirat e papërmbajtura. Si disiplinë e mendjes, ajo përmban çelësin dhe mjetin thelbësor për t'ia dalë me të keqen, e cila kërcënon jo vetëm dinjitetin e njeriut por edhe vetë ekzistencën e tij. Ajo nënkupton nënshtrimin e të menduarit dhe të sjellurit tonë ndaj të vërtetës së përjetshme. Në thelbin e saj, feja është kushtrim për aventurë shpirtërore. Ajo nuk është teologji, por praktikë e disiplinë. Ajo është ilaçi i vetëm për një krenari të shpirtit që është ndarë nga e përjetshmja; kur shpirti njerëzor mohon burimet dhe kushtet e tij dhe pretendon vetmjaftueshmëri absolute, atëherë bëhet i çmendur dhe vetvrasës. Rivendosja e marrëdhënies së humbur midis individit e të përjetshmes është qëllimi i fesë. Pikërisht

kjo marrëdhënie themelore dhe rrënjësore që është e vetmja e cila mund t'i sjellë lehtësim e harmoni njeriut në marrëdhënien e tij me Zotin, veten, njerëzit apo shoqërinë ku jeton, dhe natyrën. Nëse marrëdhëniet ndërmjet individit dhe Krijuesit të vetëm thyhet, e tërë ndërtesa e jetës së paqme dhe kuptimplote njerëzore do të rrënohet. Pikërisht për të vendosur këtë harmoni nevojiten fetë, prej të cilave Islami është i fundit.

Islam do të thotë paqe si dhe nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit, çka përbën thelbin e konceptit islam të fesë. Në Islam, nënshtrimi ndaj Zotit nënkupton – si në qëndrim, ashtu edhe në veprim – një rregullim të jetëve tona. Sipas Islamit, Zoti nuk është dogëm por ideal e forcë rregulluese në jetë, si dhe garantues për vlerat tona më të larta. Kësisoj, nënshtrimi ndaj Zotit, 'Idealit', me bindje të fortë në realitetin e tij është jetë e kaluar me virtyt e lumturi të brendshme. Një njeri që i nënshtrohet Zotit i mbetet besnik natyrës së tij të vërtetë, ndaj dhe arrin paqe të brendshme, e cila është lumturi e vërtetë, krejt e ndryshme nga kënaqësitë e kësaj bote. Kjo lumturi kompenson më së miri çdo mungesë fitimi material apo dhimbjeje fizike ose vuajtjeje.

Pikërisht përmes këtij koncepti të fesë në përgjithësi dhe Islamit në veçanti duhet të përpiqemi ta kuptojmë sesi nipi i Profetit të Islamit, Imam Husein ibn 'Aliu e shpjegon domethënien e fesë dhe funksionin e prijësisë fetare. Çështja e prijësisë së njerëzimit është temë e shumëpërsëritur në Kur'an. Saherë që Kur'ani flet për udhërrëfim hyjnor, ai thekson edhe ata që janë të denjë për të prirë. Termat kur'anorë për prijësit e njerëzimit janë *resul*, *nebi* dhe *Imam*. Dy të parët janë terma specifike, ndërsa fjala *Imam* përdoret në një kuptim mjaft të gjerë, për ata që janë të dhuntisur me cilësi të veçanta, me të cilat mund t'i udhëheqin të tjerët në drejtësishtëmëri e vepra të mira. Kështu, për shembull, në Kur'an lexojmë se kur Ibrahimit, patriarkut të profetëve semitë iu tha nga Zoti: *{Vërtet, po të caktoj Imam për njerëzimin. (Ibrahimi) tha: 'Po nga pasardhësit e mi (a do të ketë Imamë)?' Ai tha: 'Marrëveshja Ime nuk përfshin zullumqaret (ndër ta)'} (2:124)* Kështu, një Imam ose prijës i njerëzve është ai që i udhëheq ata në të gjitha rastet e ndërjegjes, e ruan në kujtesë marrëveshjen me Zotin e i mban të gjalla dhe efektive mësimet e Profetit. Ai duhet të mbrojë mesazhin fetaro-etik të shpallur nga i Dërguari i Zotit (s.a.) nga korrupsioni e ndryshimi dhe ta ruajë nga forcat reaksionare që shfaqen herë pas here.

Mesazhi i Profetit të Islamit kaloi në duart e umejjadëve të dhënë pas dynjasë, vetëm tridhjetë vjet pas kalimit së tij. Pas vdekjes së 'Aliut më 40/661, Mu'avije ibn Ebu Sufjani e zaptoi postin e udhëheqjes së bashkësisë për vete me anë të forcës dhe mashtrimit, duke i sunduar muslimanët për njëzet vjet me radhë. Me vdekjen e Mu'avijes, djali i tij Jezidi mori postin e prijësit të muslimanëve si kalif, në përputhje me testamentin e paprecedent të të atit. Sjellja antiislame e Jezidit dhe praktikata e tija të hapura jofetare ishin të mirënjohura anekënd botës muslimane dhe shkaktuan mëri e përkeqësim të imazhit të tij, sidomos ndër ata që shqetësoheshin për vlerat fetaro-etike të Islamit. Si trupëzim i të gjithë llojeve të veseve, tiranisë, padrejtësisë, shtypjes e sundimit despotik, Jezidi kërkonte nga Huseini që t'i jepte betimin si prijësi i bashkësisë islame dhe t'i nënshtrohej autoritetit të tij. Kjo ishte pika vendimtare në historinë islame, kur kuptimi i fesë duhej ripohuar dhe funksioni i prijësisë duhej ripërkufizuar. Kjo u krye nga Husein ibn 'Aliu me metodën më efektive të flijimit, vuajtjes e shehadetit. Në përgjigje të letrave

nga populli i Irakut, që e ftonin të vinte në Kufa për të marrë prijësinë e tyre, pasi nuk kishin Imam tjetër veç tij, Huseini shkroi:

Nga Husein ibn 'Aliu besimtarëve dhe muslimanëve [të Irakut]: Më keni ftuar t'ju vij sepse nuk keni Imam t'ju udhëzoi dhe shpresoni që mbërritja ime t'ju bashkojë në rrugën e drejtë dhe në hakk. Ta dini mirë se Imami mund të jetë vetëm ai që ndjek Librin e Allahut, bën drejtësinë dhe ndershmërinë sjellje e qëndrim të tij, gjykon me të vërtetën dhe i përkushtohet shërbimit të Allahut.

Në përgjigje të popullit të Basrës, Huseini u përgjigj:

... Ju kam nisur lajmëtarin tim dhe ju thërras në Librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij, [Sunnet] i cili është fshirë; bidatet kanë gëluar e marrë dhenë. Nëse më dëgjoni e m'i bindeni urdhrave, do t'ju udhëzoj në rrugë të drejtë. Paqja e Zotit qoftë me ju.

Këtu kemi vend vetëm për dy nga citimet e tilla të shumta që bëri Huseini, nga koha kur la Medinën deri në shehadetin e tij, gjashtë muaj më vonë. Këto citime janë në vetvete shpjegim i plotë i qasjes së Huseinit ndaj çështjes së prijësisë si dhe funksionit të fesë në shoqëri. Ato shpjegojnë gjithashtu detyrat e një Imami dhe natyrën e Imametit, e cila ishte shtrembëruar aq shumë në këtë çast të historisë islame.

Pikat kryesore që dalin prej tyre janë se: **(i)** Imam është ai që bashkon njerëzit; **(ii)** ai duhet t'u prijë atyre në rrugën e drejtë dhe të vërtetën; **(iii)** Kur'ani, si Libër i Zotit është një e vërtetë e përjetshme dhe detyra e Imamit është të ndjekë modelin e tij dhe ta çojë jetën në përputhje me vullnetin e Zotit; **(iv)** Imami duhet ta bëjë drejtësinë e ndershmërinë shtyllë të jetës së tij; **(v)** e vërteta, në formën e saj më universale e absolute duhet të jetë kriteri i tij i vetëm; **(vi)** ai duhet t'i përkushtohet vetëm shërbimit të Zotit.

Funksionet e Imamit të rreshtuara këtu janë edhe të posaçme edhe univiersale, përshkruese e normative, parësore dhe vlerësuese; ato mund të zbatohen në çdo shoqëri, kohë dhe epokë. Ato janë të posaçme, përshkruese e normative kur lexohen rreptësisht në kontekstin e Islamit, por universale, parësore e vlerësuese nëse lexohen në kuptimin e tyre të përgjithshëm, që rrok të gjitha fetë e tërë njerëzimin. Termat kryesorë në deklaratat e Huseinit janë: bashkimi i njerëzve (që në vetvete përbën unitet të qëllimeve), rruga e drejtë, e vërteta, drejtësia e ndershmëria, dhe përkushtimi ndaj shërbimit të Zotit. Këto janë në thelbin e të gjitha feve, si dhe të Islamit. Këtu feja nuk ndahet nga mirëqenia e shoqërisë dhe shoqëria mbështetet në realitetin e përjetshëm që krijon ndërgjegje në bashkësi.

Një rrjedhim i pandashëm nga deklaratat e Huseinit është se prijësi i njerëzve nuk është e thënë të marrë pjesë aktive në politikë ose në çështjet e qeverisjes. Funksioni i tij parësor është t'i shërbejë njerëzimit me integritet etik dhe normativ. Ai duhet të krijojë ndërgjegjësim moral dhe një ndjesi përgjegjësie që i tejkalon kufijtë e bashkësisë politike. Ai duhet t'u shërbejë vlerave shoqërore dhe shpirtërore, por mjerisht regjimet totalitare e despotike ua nënshtrojnë veprimtaritë shpirtërore dhe morale qëllimeve të tyre. Pikërisht

në këtë pikë ngrihet Huseini, që të vendosë një standart të ri prijësie për t'iu kundërvënë totalitarizmit, despotizmit dhe forcave të së keqes. Para tij ishin dy rrugë: njëra të grumbullonte forca, armë e fuqi ushtarake për të luftuar sundimin despotik të Jezidit. Kjo nuk do të kishte qenë e vështirë për nipin prestigjioz të Profetit, sikur të kish dashur t'i përvishej një veprimi të tillë. Por veprimet e Huseinit tregojnë se që nga fillimi deri në fund strategjia e tij synonte një qëllim shumë më të lartë sesa thjesht ngjitja në kalifat, term ky që i jepet autoritetit të përkohshëm në Islam. Nuk ka dëshmi që, teksa ishte në Mekë, ai u përpoq ndopak të rreshtonte mbështetës aktivë nga mesi i njerëzve që u mblodhën rreth tij, ose ta përhapte kauzën e tij në mesin e numrit të madh të njerëzve që vinin aty për haxh; gjithashtu nuk ka dëshmi se ai u përpoq t'i dërgonte lajmëtarët e tij për të nxitur ndonjë rebelim në provinca si Jemeni ose Persia, që ishin simpatizues të familjes së tij, edhe pse u këshillua nga disa pjesëtarë të saj që ta bënte këtë. Mbi të gjitha, sikur ai të kishte vepruar shpejt pas ftesës së kufasve, kur kontrolli umejjad mbi qytet ishte i dobët, ai mund të kishte patur mundësi të mira suksesi për marrjen e pushtetit. Në periudhën gjashtëmujore para betejës së Qerbelasë, Huseini nuk bëri asgjë për ta konsoliduar fuqinë e tij ushtarake. Në vend të kësaj, përgjatë tërë kohës ai u përgatit për një tjetër strategji revoluconi.

Disa nga autorët që kanë shkruar mbi Qerbelanë, duke e vështruar atë nga standartet e zakonshme të luftës dhe fitores, e përshkruajnë veprimin e Huseinit si përpjekje ambicioze për të marrë pushtetin politik dhe si gabim gjykimi. Fjalimet, kumtesat, letrat dhe pohimet e shumta të Huseinit dëshmojnë për faktin se ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për situatën dhe rrjedhojat. Mjafton të theksohet se në rrugën nga medina në Mekë, e më pas kur ishte 'Shtëpia e Zotit' për Kufën, dhe më në fund përgjatë udhëtimit nga Meka në Kufe ai u informua dhe u paralajmërua nga dhjetëra njerëz për rrezikun dhe se 'zemrat e irakenëve ishin për të por shpatat e tyre ishin për umejjadët'. Por përgjigjet e Huseinit ndaj të gjithë atyre që u përpoqën ta shmangnin nga qëllimi i tij ishin pak a shumë në të njëjtën frymë:

Ia lë Allahut të zgjedhë ç'është më e mira... Allahu s'i kundërvihet atij që ndjek kauzën e drejtë.

Nga këto përgjigje është e qartë se Huseini ishte krejtësisht i vetëdijshëm për rreziqet që do të ndeshte dhe se ai kishte një strategji e plan të caktuar në mendje për të sjellë një revolucion në ndërgjegjen e bashkësisë muslimane. Për më tepër, nga burimet është gjithashtu shumë e qartë, siç u theksua më lart, se Huseini nuk u përpoq të organizonte ose mobilizonte mbështetje ushtarake, të cilën do të kishte ta bënte lehtë në Hixhaz, e as që u përpoq ndonjëherë të përdorte çfarëdolloj fuqie fizike që kishte në dispozicion. Përkundrazi, nga çasti kur la Mekën, ai i mblodhi disa herë ata që e shoqëronin e u kërkoi ta linin vetëm dhe të shkonin në siguri, ku e fundit prej këtyre kërkesave u bë natën para Ashures. A është e imagjinueshme që dikush i cili përpiket për pushtet politik t'u kërkojë mbështetësve të tij ta lënë? Askush nuk mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje pozitivisht. Ç'kishte ndër mend Huseini atëherë? Përse iu drejtua ai prapëseprapë Kufës?

Një studim dhe analizë e kujdesshme e ngjarjeve të Qerbelasë zbulon se që nga fillimi Huseini planifikoi një revolucion të plotë në ndërgjegjen fetare të muslimanëve. Të gjitha

veprimet e tija tregojnë se ai ishte i vetdijshtë për faktin se një fitore e arritur përmes fuqisë ushtarake është gjithmonë e përkohshme, sepse një fuqi tjetër më e madhe mundet, në rrjedhën e kohës, ta rrëzojë në rrënoja. Por një fitore e arritur nëpërmjet vuajtjes dhe flijimit është e përvetshme dhe lë gjurmë të pashlyeshme në ndërgjegjen e njeriut. Huseini u rrit në prehrin e themeluesit të Islamit dhe kishte trashëguar dashurinë dhe devotshmërinë e mënyrës islame të jetesës nga i ati. Me kalimin e kohës, ai vuri re ndryshimet e mëdha që po ndodhnin në bashkësi lidhur me ndjenjat dhe moralin fetar. Procesi i natyreshëm i konfliktit dhe luftimit ndërmjet veprimit e kundërveprimit ishte tani në punë e sipër. Pra, veprimi progresiv islam i Muhammedit (s.a.) ia kishte dalë ta shtypte konservatizmin arab, të trupëzuar në praktikën dhe mënyrat e mendimit paraislamike pagan. Mirëpo për më pak se tridhjetë vjet, ky konservatizëm arab e kishte rigjallëruar veten si kundërveprim i fortë për ta sfiduar sërish veprimin e Muhammedit (s.a.). Forcat e këtij kundërveprimi ishin vënë tashmë në lëvizje me vendosjen e Mu'avijes, por pasimi i tij nga Jezidi ishte një shenjë e qartë se forcat reaksionare ishin mobilizuar dhe tani ishin rishfaqur plot vrull. Forca e këtij kundërveprimi të trupëzuar në karakterin e Jezidit ishte tanimë aq i fuqishëm sa të shtypte, ose të paktën të fshinte, veprimin e Profetit. Sjellja e tij qëndronte në talljen e përqeshjen e Sunnetit të Muhammedit dhe normat e Kur'anit. Ai e kundërshtoi haptazi profetësinë e Muhammedit s.a. dhe shpalljen e marrë prej tij. Tani po ky Jezid ishte bërë kryetari i bashkësisë muslimane dhe i kërkonte betim Huseinit. Pranimi i Jezidit nga ana e Huseinit, me qëndrimin reaksionar të të parit ndaj normave islame nuk do të kishte nënkuptuar thjesht një aranzhim politik, por mbështetje të karakterit të Jezidit dhe mënyrës së tij të jetesës. Kësisoj i tërë sistemi etik dhe fetar i Islamit, në mendimet e Huseinit, kishte nevojë të dëshpëruar për riaktivizimin e veprimit të Muhammedit (s.a.) ndaj kundërpërgjigjes së vjetër arabe, duke kërkuar një rishkartisje të plotë.

Ai e kuptoi që thjesht fuqia e armëve nuk do ta shpëtonte veprimin dhe ndërgjegjen islame. Sipas tij, asaj i nevojitej një tundje dhe shkundje zemrash e ndjenjash. Kjo, vendosi ai, mund të arritej vetëm përmes flijimit dhe vuajtjes e kësisoj, për ta ruajtur Islamin e vlerat e tij, lirinë e njeriut dhe dinjitetin e tij, Huseini bëri një nga sakrificat më të mëdha në historinë njerëzore. Tetëmbëdhjetë anëtarë meshkuj të familjes së tij, përfshirë një bir 6-muajsh e dyzetekatër shokë të tij u vranë përpara tij dhe pastaj vetë ai dha jetën në altarin e së vërtetës dhe të drejtave të njeriut.

Trupi i Huseinit, i çarë tashmë nga plagë të shumta, u shtyp nën thundrat e kuajve, çadrat e tij u plaçkitën dhe u dogjën; gratë e pambrojtura dhe fëmijët u nxorën paturpësisht në paradë nëpër rrugët e Irakut dhe Sirisë si robër dhe u poshtëruan në oborret gëluese të Ibn Zijadit në Kufe dhe Jezidi në Damask.

Huseini ishte plotësisht i vetdijshtë për shkallën e natyrës brutale të forcave reaksionare. Ai e dinte se pasi ta vrisnin, umejjadët do t'ia bënin të shoqen dhe fëmijët robër e do t'i çonin nga Kufa në Damask. Ky karavan robëresh me familjen më të ngushtë të Profetit do të bënte publik mesazhin e Huseinit dhe do t'i detyronte zemrat e muslimanëve të thellohen për tragjedinë. Ajo do t'i bënte muslimanët ta mendonin tërë çështjen dhe do t'ua zgjonte atyre ndërgjegjen. Dhe kjo është pikërisht ajo që ndodhi; Huseini ia doli në qëllimin e tij. Është e vështirë sot të vlerësohet saktësisht impakti i veprimit të Huseinit

ndaj moralitetit dhe mënyrës islame të mendimit sepse ai ka ngadhënjyer. Sikur Huseini të mos e kishte tundur dhe zgjuar ndërgjegjen e muslimanëve me anë të kësaj metode, a mund të thuhet se mënyra e jetesës së Jezidit nuk do të ishte bërë sjellja standarde në bashkësinë islame, e mbështetur dhe e pranuar nga nipi i Profetit (s.a.)? Edhe pas Jezidit, sundimtarët despotikë mbajtën fuqinë dhe pushtetin në Islam, dhe karakteri e sjellja personale e këtyre tiranëve nuk ka qenë shumë e ndryshme nga ajo e Jezidit, por ndryshimi në mendim që mbizotëroi pas flijimit të Huseinit shërbyen gjithmonë si kriter dallimi ndërmjet konceptit islam të prijësisë dhe sjelljes së sundimtarëve totalitarë e despotikë. Huseini i thotë botës se nuk ia vlen të shkatërrohet njeriu; ajo që duhet të shkatërrojmë janë veprimet dhe sjellja antinjerëzore e njerëzve. Nëse sundimtarët rrezohen por sistemi nuk ndryshon, nuk fitohet asgjë.